

Jetëshkrim

Znj. Suela Musta është zgjedhur Anëtar i Autoritetit të Mediave Audiovizive me Vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, nr. 51/2016, datë 22 Korrik 2016.

Znj. Musta është diplomuar për Gazetari dhe është në pritje të mbrojtjes së tezës së doktoraturës, pranë Departamentit të Gazetarisë dhe Shkencave të Komunikimit, Fakulteti Filologjik, Universiteti Tiranë. Në vitin 2011 kreu studimet Master për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Fakultetin Histori-Filologjisë. Fillimet e karrierës në Gazetari, Znj. Musta i ka në televizionet e para private, në fushën e politikës dhe kronikës parlamentare, si ish televizioni "Arbëria", "Telenorba", (1998-2000) dhe më pas për pesë vite si gazetare dhe redaktore politike në Top Albania Radio, radio e parë kombëtare private.

Gjatë konfliktit etnik në Kosovë, 1999, ajo ka bashkëpunuar me disa media të shtypit dhe stacione televizive të Italisë si (Rai Uno, Gazeta "La Stampa", si dhe me disa të përditshme të shtypit evropian të kohës.

Karriera e Znj. Musta ka vijuar si korrespondente e Shqipërisë për institute të ndryshme ndërkombëtare, koordinatorë projektsh, bashkëpunime me organizata joqeveritare në fushën e të drejtave dhe promovimit të vajzave dhe grave, zëdhënëse, këshilltare e më pas koordinatorë e Sektorit të Informacionit dhe Komunikimit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përgjegjëse e faqes së internetit në Kuvendin e Shqipërisë. Në korrik të vitit 2010 u zgjodh nga Parlamenti Shqiptar si anëtare e Këshillit Drejtues të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (AMA).

Znj. Musta është autore e artikujve të ndryshëm në revista shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka qenë bashkëpunëtore e rregullt e revistës tremujore "Tribuna e Kuvendit" dhe botimit "Diplomacia Parlamentare" në vitet 2009-2013. Njëherësh ka punuar dhe në revistën Almanak i MTKRS, vitet 2006-2008.

Znj. Musta ka kryer një sërë trajnimesh dhe specializime në vende të ndryshme të Evropës, SHBA dhe Afrikë.

Ajo flet italisht, anglisht, frëngjisht dhe spanjisht.